

STATUTI I SHOQERISE TREGTARE

"A-Z LTD".

Neni 1

Emri

Emri i shoqerise eshte "A-Z LTD".

Neni 2

Forma

Forma e shoqerise eshte ajo e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ("SHPK"), sipas nenit 68 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008.

Shoqeria "A-Z LTD".

zoterohet nga ortaku i vetem :

ERMAL SELMAN TELHA - i datelindjes 24.09.1986 lindur ne Korce i pajisur me leternjoftim me nr. Personal I60924023P.

i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Neni 3

Data e themelimit

Shoqeria eshte themeluar me date 11.05.2023.

Neni 4

Ortaket

Ortaket i vetem i shoqerise eshte:

ERMAL SELMAN TELHA - i datelindjes 24.09.1986 lindur ne Korce i pajisur me leternjoftim me nr. Personal I60924023P.


Neni 5

Selia

Selia e shoqerise eshte ne: Lagjja 28 Nentori, Rr. Qemal Stafa, zona kadastrale nr. 8522, pasuria nr.8/375-N9, pallati nr. 422/11, kati 2, Elbasan.

Neni 5/1

Zyra Qendrore



Zyra qendrore e shoqerise tregtare eshte ne Lagjja 28 Nentori, Rr. Qemal Stafa, zona kadastrale nr. 8522, pasuria nr.8/375-N9, pallati nr. 422/11, kati 2, Elbasan. Ne zbatim te nenit 8 pika 2 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", shoqeria tregtare i nenshtrohet dispozitave te ketij ligji.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Shoqeria ka si objekt, por pa u kufizuar, realizim, supervizim dhe implementim i projekteve te kondicionimit HVAC, instalim te sistemeve smart home, projekte hidro, elektrike, MNZ etj.

Gjithashtu, shoqeria mund te fokusohet edhe ne investime ne pasuri te paluajtshme, projektme, zbatime te projekteve te ndryshme nga stafi i shoqerise ose nepermjet kontratave te sherbimit me te trete, pjesemarrjen ne investime me kuota, konsulence ne fushen e marketingut, negociim ne procesin e shit-blerjes/dhenies me qira te pasurive te paluajtshme, negociim i kontratave sipermarrese mes paleve te interesuara, konsulence ne fushen financiare, juridike, inxhinierike etj.

Aplikim i sistemeve te aluminit dhe xhamit, kryesisht vetrata, dritare, fasada xhami, fasada te ventiluara. Perpunim i materialeve te drurit dhe prodhim mobiljesh.

Ofrimi i sherbimit te konsulences, ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave, informatikes etj. Organizimi dhe menaxhimi i eventeve promovues ne hapesiren kombetare dhe ate nderkombetare. Kordinim i mardhenieve tregtare dhe perfaqesim i te treteve sipas nevojave dhe kontratave te nenshkruara. Ekspertiza juridike mjedisore, vendime te ndikimit ne mjedis (VNM), audit te efecences se energjise etj. Produksione mediatike dhe ofrime sherbimesh qe lidhen me teknologjine e informacionit.

Shoqeria mund te ndermarre aktivitet tregtar, financiar, qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem ne menyre qe te arrihet dhe permbushen objektivat e shoqerise pa u kufizuar nga asgje tjeter pervec dispozitave ndaluese te kuadrit ligjit te Republikes se Shqiperise. Objekti i veprimtarise se Shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te ngushtohet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 7

Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj dhe vepron si person juridik me personalitet te plote per te vepruar per nje periudhe te pa caktuar, filluar nga data 11.05.2023.

Neni 8

Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre

Personi pergjegjes per administrimin dhe perfaqesimin e shoqerise eshte :

ERMAL SELMAN TELHA - i datelindjes 24.09.1986 lindur ne Korce i pajisur me leternjoftim me nr. Personal I60924023P.

Kompetencat e perfaqesimit eshte i plote duke i dhene tager perfaqesuesit, te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha marredheniet juridike dhe per te gjitha veprimet juridike ku nje nga palet e ketyre marredhenieve juridike apo veprimeve juridike, shfaqet shoqeria "**A-Z LTD**".

ERMAL TELHA emerohet si Administrator dhe perfaqesues i shoqerise ne marredhenie me te tretet, per nje periudhe 5 vjecare duke filluar nga data 11.05.2023

Neni 8/1

Ndalime dhe kufizime


Duke qene se perfaqesuesi ligjor gezon njekohesisht edhe cilesine e administratorit dhe ortakut te shoqerise, bazuar ne nenin 7 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", **ERMAL TELHA** si individ, i ndalohet te lidhe kontrata huaje apo garancie me shoqerine.

Ne lidhje me kontrata e tjera, pervec atyre te permendura ne piken 1 te ketij neni, parashikohet detyrimi qe keto kontrata te lidhura mes ketyre personave dhe shoqerise "**A-Z LTD**" te regjistrohen ne nje procesverbal i cili behet ne zyren qendrore te shoqerise dhe te merret miratimi i ortakut apo ortakeve te tjere te shoqerise.

Neni 9

Specimenti i nenshkrimit (firmes) se personave qe perfaqesojne shoqerine perpara te treteve

Emer, Mbiemer, Firme

Ernal Telha 

Neni 10

Vlera e kapitalit themeltar te nenshkruar

Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise ka nje vlere prej 500000 Leke (peseqind mije) leke.

Neni 11


Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar

Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 1 (nje).

Neni 12

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar

Vlera nominale e kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 500000 leke.



Neni 13

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar eshte :

Ortaku **ERMAL TELHA 100 %**

Neni 14

Vlera dhe lloji i kontributit te ortakeve

Vlera e kontributit te ortakut **ERMAL TELHA** eshte 500000 leke.

Lloji i kontributit te ortakut **ERMAL TELHA** eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 15

Kapitali i nenshkruar do te paguhet nga ortaku ne menyre te rregullt, plotesisht dhe rregullisht ne llogarine bankare te shoqerise.

Neni 16

Ndalimi i konkurrences

Ndalimi i permendur ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", mund te shfuqizohet nepermjet nje autorizimi te posacem, te dhene nga ortaket e tjere sipas dispozitave te nenit 36 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 16/1

Ne mungese te nje shfuqizimi te parashikuar nga neni 16 i ketij statuti, ndalimi i konkurrences i parashikuar ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", mbetet ne fuqi deri ne 1 (nje) vit kalendarik pas humbjes se cilesive te permendura ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901.

Neni 17

Kalimi i kuotave

Kushtezohet kalimi i kuotave te ortakeve te shoqerise "**A-Z LTD**", me te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te shoqerise.


Ne rast se e drejta e parablerjes nuk eshte shfrytezuar nga asnje prej ortakeve te tjere te shoqerise, atehere per kalimin e kuotave sipas nenit 73 pika 1 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", duhet marre miratimi i ortakeve qe perfaqesojne 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise i cili autorizon keto kalime.

Fitimi apo kalimi i kuotave me kontrate, duhet te realizohet ne menyre te detyrueshme, ne cdo rast, me akt noterial.

Neni 18

Shperndarja e fitimeve

Ortaket kane te drejte te ndajne pjeset e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise.



Neni 18/1

Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

Neni 19

Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme, eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;

- Ndryshimet e statutit;
- Emerimin e shkarkimin e administratorit;
- Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- Percaktimin e shperblimeve per administratorit, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;
- Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratori, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- Pjestimin e kuotave dhe anulimi i tyre;
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- Nisjen e nje hetimi te posacem per parregullsitet pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare, hetim ky i cili kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes;
- Miraton bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve, dokumente keto te paraqitura nga administratori.
- Vendors per likuidimin me nje procedure te pershpejtuar sipas nenit 25 te ketij statuti.
- Ceshtje te tjera te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 19/1

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Asamblene e Pergjithshme, kane te drejte ta therrasin:

1- Administratorin

Ortaket e pakices sipas nenit 84 te ligjit nr.9901.

Asambleja e Pergjithshme thirret:

a- Nese sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.


b- Kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, pasuri te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

c- Kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te asetave te shoqerise, qe rezulton nga pasqyrat e fundit te certifikuara.

Ne rastet "a-" dhe "c-", te ketij neni, asamblese i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.

Ne rastet e mesiperme (a, b, c te ketij neni), asambleja mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo duke bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

Neni 19/2



Menyra e thirrjes se asamblese

Asambleja e Pergjithshme thirret permes nje njoftimi me shkrese.

Asambleja e Pergjithshme thirret edhe permes njoftimit me ane te postes elektronike.

Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Nese asambleja nuk eshte thirrur sipas rregullave te percaktuara me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord per te marre vendime.

Pjesemarrja e ortakeve ne mbledhjen e asamblese mund te behet e mundur edhe me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

Neni 20

Marrja e vendimeve

Ne lidhje me vendimet per:

1- Ndryshimin e statutit.

Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar.

Shperndarjen e fitimeve.

Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise

Asambleja vendos me te pakten $\frac{3}{4}$ e votave te ortakeve pjesemarres ne mbledhjen e asamblese.

Ne lidhje me vendimet e tjera, te renditura ne nenin 19 te ketij statuti, asambleja vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres

Te gjitha vendimet e asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal, ne perputhje me kushtet dhe rregullat e percaktuara ne nenin 90 te ligjit nr.9901.

Neni 20/1

E drejta e votes


Cdo kuote jep te drejten e nje vote.

Neni 21

Te drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikaten tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- Te perfaqesoje shoqerine tregtare;
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- Te krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- Te kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sipas ligjit "Per Qendren Kombetare teBisnesit".
- Te raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- Asambleja e Pergjithshme me vendim te vecante, mund te percaktoje qe te kete rradhe hierarkike ne administrim, nga administratore te caktuar duke specifikuar rrethanat e kesaj perpariesie ndermjet administratorit.



- Ne rast likuidimi ne gjendjen e aftesise paguese, i njofton per regjistrim QKB-se te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre.

Neni 22

Shperblimi i administratorit

Shperblimi i administratorit percaktohet me vendim te zakonshem te ortakeve.

Shperblimi i administratorit duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, asambleja e pergjithshme mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratorit ne masen e pershtatshme.

Kriteret e shperblimit, Shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratorit ne strukturen e kostove te shoqerise publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 23

Emerimi i likuiduesit

Ne rast se asambleja e pergjithshme vendos per likuidimin e shoqerise ne gjendjen e aftesise paguese, ajo eshte e detyruar te caktojë likuiduesin, brenda 30 diteve pas prishjes.

Ne caktimin e likuiduesit duhet te kihet parasysh se ky caktim nuk duhet te paraqese arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likuiduesi i caktuar.

Neni 23/1

Te drejtat dhe detyrat e likuiduesit

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emerimit te tij.

Kufizime te caktuara per veprimtarine e likuiduesit, mund te vendosen nga ortaku i vetem ne aktin e emerimit te likuiduesit. Keto kufizime publikohen ne menyre elektronike sipas nenit 61 te ligjit nr.9723 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit" dhe kane efekt edhe ndaj te treteve duke u quajtur te njohura publikisht ne perputhje me nenin 12 te ligjit nr.9901.

Likuiduesi ka detyre te ftojë kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e shoqerise.

Detyrat kryesore te likuiduesve jane:

- 1) Mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise.
- 2) Mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera.
- 3) Shitja e pasurive te shoqerise.
- 4) Shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e preferimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- 5) Kryerja e veprimeve te reja tregtare ne funksion te mbylljes se nje veprimi te paperfunduar.

Kur likuiduesit vejne re se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e pretendimeve te ngritura nga kreditorët, likuiduesi pezullon proceduren e likuidimit dhe i kerkon gjykates nisjen e procedurave te falimentimit.


Neni 24

Shperndarja e aktiveve

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditoreve, likuiduesi i shperndan ortakeve aktivet e mbetura.

Neni 25

Likuidimi i thjeshtezuar



Me vendim te saj, asambleja e pergjithshme mund te vendose per likuidimin e pershpejtuar.
Me marrjen e ketij vendimi dhe regjistrimin e tij te rregullt ne regjistrin e vendimeve, sipas kriterëve te ketij statuti, asambleja e pergjithshme eshte e detyruar te deklaroje perpara gjykates perkatese se te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditoreve jane shlyer e jane rregulluar te gjitha marredheniet me punemarresit.
Administratori i shoqerise njofton per regjitrin prane QKB-se vendimin e mesiperm.
Administratori dhe ortakët, jane pergjegjes solidarisht, per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likuidimit te thjeshtezuar.

Neni 26

Dispozita te fundit

Ky statut hyn ne fuqi me regjistrimin e tij prane Qendres Kombetare te Bisnesit .

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "A-Z LTD".

ERMAL TELHA

Ernal Telha
Ernal
23